



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 2665 Prot
Nr. 696 Regj

Tiranë, më datë 10.12.2019

VENDIM

(Për shpalljen në ankand të III të pasurisë së paluajtshme)

Pranë zyrës përmbarimore private “Bailiff Services Albania” sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është vënë në ekzekutim titulli ekzekutiv **Kontratë Kredie Bankare nr.206 datë 18.07.2008**. Për këtë titull ekzekutiv nga Gj.Rr.Gj.Durrës është lëshuar **urdhër ekzekutimi nr.11-2010-1416(213) akti datë 06.04.2010** me palë:

- **Kreditor:** Credins Bank sh.a.
- **Debitor:** Ernard Oreshka
- **Dorëzanës:** Gerta Oreshka dhe Zyhra Oreshka
- **Hipotekues:** Ernard Oreshka dhe Gerta Oreshka
- **Objekti:** Kthim kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitore ekzekutimi i titullit ekzekutiv në mënyrë vullnetare. Me marrjen dijeni nga ana e palës debitore nuk është kryer asnjë veprim. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm, duke vendosur në bazë të nenit 560 të K.Pr.Civile masën e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore, e lënë kolateral në çastin e marrjes së kredisë.

Me vendimin Nr.660, datë 03.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin Nr. 73, datë 19.01.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është përcaktuar si cmim fillestar të daljes së dy sendeve në ankand, një cmim i cili të derminojë që pas ankandit të parë, vlera e pasurive të përshkruara në kontratën e datës 18.07.2008, të mos jetë më pak se 44,280,000 lekë për te dyja pasuritë e paluajtshme sipas përcaktimit të nenit 7 të kësaj kontrate.

Me shkresën Nr 2179 Prot datë 27.09.2019 është proceduar me “Vendim për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm”, për të cilin palët kanë marrë dijeni rregullisht dhe nuk është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, sic e parashikon ligji.

Më datë 03.12.2019 është mbajtur procesverbali i ankandit të dytë, i cili është mbyllur pa asnjë ofertues.

Më datë 04.12.2019 është proceduar me vendim për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm, Nr 2651 Prot.

Në bazë të nenit 567, 568, 569, 570 e në vijim të K.Pr.Civile

VENDOSA

1-Të shpall ankandin e III (tretë) për shitjen e pasurive te paluajtshme sipas vendimit Nr.660, datë 03.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin Nr. 73, datë 19.01.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë,

- Pasuri Nr 46/187-N1, vol. 35, faqe 154, ZK 8515, me vërtetim pronësie dt. 16.07.2008, me sip. 124 m2, me adresë Plazh, Lagja 13, Durrës, në pronësi të Ernard Ymer Oreshka dhe Gerta Vladimir Oreshka.

Cmimi i ankandit të tretë i pasurisë së paluajtshme është në vlerën 20 420 032.5 lekë.

- Pasuri Nr 46/187-N7, vol. 35, faqe 166, ZK 8518, me vërtetim pronësie dt. 16.07.2008, me sip. 118 m2, me adresë Plazh, Lagja 13, Durrës, në pronësi të Ernard Ymer Oreshka dhe Gerta Vladimir Oreshka.

Cmimi i ankandit të tretë i pasurisë së paluajtshme është në vlerën 19 431 697.5 lekë.

2-Secili ofertues duhet të depozitoje si garanci në llogarinë e Zyrës Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me NUIS L02127004B shumën prej 10% të çmimit fillestar, në numrin e llogarisë pranë Bankës Credins sh.a IBAN AL 4621 2110 1600 0000 0000 253 135.

3-Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 16.12.2019 deri në datë 20.12.2019 dhe zhvillohet në këtë datë orë 16:00 pranë Zyrës Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k.

4-Publikimi i ketij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.

5-Ky vendim i komunikohet palëve, të cilet kundër tij kanë të drejten e ankimit brenda 5 diteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

Zyra Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k
Përmbartues Gjyqësor Privat
ERION LLALLA

